



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), neni 37.3 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 11.02.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. PAJTIM BALAJ** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje-LVV" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Fitim Haziri.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Pajtim Balaj dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 10.02.2020, Nr.129/2020, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Fitim Haziri, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të zgjedhjes deputet në Kuvendin e Kosovës, nga zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rënditur është z. Pajtim Balaj, i cili ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 11.02.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

